Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
18.07.2017
02-016/745

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr o3/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008 dhe nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/ 491 të datës 21.04.2011 dhe rregullores për subvencione të datës 23.12.2016 me nr. 01-013/1706, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

# VENDIM
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 2.000,00€ KLUBIT FUTBOLLISTIK "VITIA " NGA VITIA

**I.**

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë i NDAN shumën e mjeteve financiare në shumë prej **2.000,00** euro me shkronja ( dymijë euro) Klubit Futbollistik " KF Vitia " nga Vitia në emër të mbështetjes financiare të këtij klubi futbollistik për zhvillimin e garave sportive.

**II**

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga fondi burimor 21 dhe kodi ekonomik për subvencione dhe transfere i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi transferohen në llogari të KF "Vitia" nga Vitia.

Obligohet kryetari i KF "Vitia" nga Vitia që të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

**III**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

**IV**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

DREJTORI
Milot Lala

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Viti, 18.07.2017
Vendimi u dorëzohet:

1. KF "Vitia" Viti
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi